



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

**Procesverbal për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës së prokurimit në lote me objekt “Blerje zgara dhe puseta”**

I mbajtur sot në datë 17.07.2023 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt “ Blerje zgara dhe puseta”, me fondi limit 50.398.500 (pesëdhjet milion e treqind e nëntëdhjet e tetë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote **sa herë kjo është e mundur**. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyet e mëposhtme:

**Së pari**, kemi të bëjmë me të njëjtën familje mallrash, pra me natyrë të njëjtë, që në thelb i përkasin të njëjtës kategori.

**Së dyti**, Autoriteti Kontraktor ushtron një veprimtari të gjerë në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë, ku përfshihen jo vetëm zonat urbane por edhe të gjitha territoret e ish-komunave, pra zonat rurale. Objekti i veprimtarisë së Autoritetit Kontraktor përfshin mirëmbajtjen e rrugëve urbane dhe rurale, e rrjetit të ndriçimit publik, e sinjalistikës rrugore (vertikale dhe horizontale, me apo pa ndriçim) si dhe mirëmbajtjen e kanaleve kulluese dhe vaditëse.

Theksojmë se një nga objektet kryesore dhe të rëndësishme të veprimtarisë së saj është mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të shiut (zevendesimi i zgarave dhe kapakëve te pusetave të llojeve të ndryshme) në të gjithë territorin e Bashkisë Tiranë dhe mirëmbajtjen e bazamenteve të pemëve në rrugë e trotuare.

Si rrjedhim, AK-ja gjykon se vetëm marrëveshja kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara është e përshtatshme pasi për shkak të arsyeve teknike dhe organizative, lëvrimi i mallrave nga operatorë të ndryshëm nuk është i favorshëm, sepse do të shkaktonte vështirësi AK-së duke u shoqëruar me kosto shtesë, vonesa në kryerjen e furnizimit dhe si rezultat mosrealizimin e punëve sipas objektivave të AK-së.

2. Ndryshimi i OE në rast se kjo marrëveshje do të lidhej me disa OE (pra rrjedhimisht ku jo të gjitha kushtet do të ishin të përcaktuara) do të shkaktonte kosto shtesë, pasiguri dhe konfuzion për OE të suksesshëm, gjë që do të shoqërohej me rritjen e afateve të lëvrimit duke patur parasysh nevojën për këtë mall nga ana e AK-së. Lidhja e MK me një OE të vetëm, do të shoqërohej me mirëorganizimin e këtij të fundit për sigurimin e mallit në kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.

Gjithashtu, theksojmë se marrëveshja kuadër me disa OE ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara nuk konsiderohet kontratë. Kjo do të thotë që AK-ja nuk kanë mekanizma detyruese për OE të shpallur të suksesshëm për pjesëmarrjen e tyre në minikonkurse dhe rrjedhimisht në lidhjen e kontratave pas zhvillimit të tyre. Pasiguria dhe vonesat mund të sjellin dështim në furnizim, duke patur impakt direkt në veprimtarinë e AK-së.

Si përfundim, me qëllim garantimin e furnizimit në afatet kohore të përcaktuara, MK me një OE të vetëm fitues do të garantonte sigurinë e furnizimeve sipas kushteve të përcaktuara dhe brenda afateve të kërkuara duke sjellë stabilitet në menaxhimin e kontratave dhe të nevojave të AK

## **NJËSIA E PROKURIMIT**